



**VITI I RI HIXHRI
DHE SIMBOLIKAT
E RIMËKËMBJES ISLAME**



**TË RINJ TË PËRJETËSUAR
NË SUREN EL-KEHF**



VLERA E SADAKASË

UDHA ISLAME

Viti 20 - Nr. 7 (233), Korrik, 2022

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIA SHKODER1990

Ky është Islami i rimëkëmbjes..!

*“Ky Islam është i rimëkëmbjes, i forcës,
i pushtetit, i të mirës e i çdo mirësie për çdo
njeri dhe i çdo gjëje në rruzullin tokësor,
i mëshirës për çdo gjë dhe çdo kënd.”*



40 HAXHILERË NGA SHKODRA U PËRCOLLËN PËR TË KRYER HAXHIN E SIVJETSHËM

Ditën e hënë, më 4 korrik 2022, pasi u fal me xhematë namazi i iqindisë në xhaminë e Parrucës, u bë përcjellja e 40 haxhilerëve nga Shkodra, të cilët u nisën për në Mekë për të kryer detyrën e Haxhit.



40 haxhilerë nga Shkodra u përcollën për të kryer Haxhin e sivjetshëm dhe do të qëndrojnë në vendet e shenjta, deri më 22 korrik 2022.

Në prani të mediave, Myftiu i Shkodrës...

(f. 16)

U ZHVILLUA CEREMONIA E MBYLLJES SË KURSIT VEROR “BUZ’QESH”

Ditën e xhuma, më 22 korrik 2022 në ambientet e xhamisë “Ebu Bekër”, përmes një ceremonie u bë mbyllja e kursit veror intensiv, “Buz’qesh”, i organizuar nga Myftinia Shkodër.



Fillimisht, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni falënderoi bashkëpunimin e vyer të teologes Zamira Bushati për koordinimin e kësaj platforme të re në edukimin e fëmijëve me dashurinë ndaj Krijuesit të gjithësisë, mësueset psikologe, znj. Admira Guri dhe znj. Almeda Tusha...

(f. 18)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

VITI I RI HIXHRI DHE SIMBOLIKAT E RIMËKËMBJES ISLAME

muaji i parë i vitit të ri Hixhri.

Teksa bëhemi gati të përcjellim një vit dhe të nisim një vit të ri, natyrshëm që gjithësecili nga ne e ka për detyrë që të ulet paksa dhe të mendojë dhe të pyesë çfarë kam bërë unë në këtë vit dhe cila është analiza më e mirë që duhet të kem në marrëdhënie me vitin që sapo bëhet gati të perëndojë me perëndimin e diellit të kësaj dite dhe, çfarë duhet të mendojë dhe të veprojë si dhe të përgatisë për një vit që po vjen me akshamin e kësaj dite? Sonte, mbas këtij akshami ne hyjmë në një vit të ri, bota islame hyn në një vit të ri!

A duhet të mendojë myslimani dhe të lejojë që koha, muajt, ditët dhe vitet të kalojnë në mënyrë të rëndomtë? Ç'rëndësi ka që është vit i ri? Ç'rëndësi ka që kaloi dhe një ditë? Ç'rëndësi ka që kaloi edhe një muaj? Ç'rëndësi ka që erdhi edhe një vit? Ç'rëndësi ka që është 1444?

Të ndalemi në tre stacione në këtë hytbe të shkurtër për të folur shkurtimisht dhe përciptas rreth kalendarit, rreth hixhretit në vetvete dhe rreth hajdutit të Habeshesë. Ky, hajduti i Habeshesë është edhe thelbi i kësaj hytbeje.

E para, kalendarin ta çlirojmë nga komplekset që vlojnë sot në vulgun e komunikimit të rrjeteve sociale, ligjëratave e shkrimeve, opinioneve nga foltoret më të larta e deri në kafenet më të papërfillshme të provincave.

Kalendar!

Pse ka një kalendar hënor? Pse ka një kalendar për myslimanët?

Këtë mesele na e ka zgjidhur me pak rreshta Imam Sujuti në tefsir, ku na tregon për shënimet e Ibn As'akirit të famshëm. Në librin e tij: Historia e Damaskut, thotë shprehimisht se: "Njerëzit përherë kanë përlogaritur historinë e tyre dhe kanë pasur një pikënisje për historinë dhe kalendarin e tyre". Fillimisht, pikënisja ishte zbritja e Ademit (a.s) nga xheneti. U dërgua Hz. Nuhu (a.s) dhe njerëzit morën në konsideratë duanë/lutjen e madhe që bëri kundër popullit të tij, pikërisht tufani i famshëm.

Pastaj u bë pikënisje për ndryshimin e historisë, zjarri i Hz. Ibrahimit. (Ajo mrekulli e madhe që nuk ishte parë ndonjëherë dhe nuk do të shihet më kurrë. Shuarja e atij zjarri të madh ose kthimi i atij zjarri të madh në një lëndinë të freskët dhe të paqte për Hz. Ibrahimin (a.s), që nuk u prek nga asnjë e keqe prej atij zjarri, të cilit Allahu (xh. sh) ia hoqi vetinë djegëse. Viti i pestë pas zjarrit, viti i dhjetë pas zjarrit e kështu me radhë...)

Pastaj thotë: Beni ismailët, pra djemtë e Hz. Ismailit (a.s), e ndryshuan kalendarin dhe morën pikënisje ndërtimin e Qabes. (Shtëpia e parë e adhurimit për racën njerëzore është ajo në qytetin e Mekës, ndërtimi i shtëpisë së parë të adhurimit). Pastaj, viti i filit, viti i elefantit (për të cilën Allahu (xh. sh) i tregon pejgamberit Muhammed (a.s) në Kur'an: "A nuk e sheh se çfarë bëri Zoti yt me të zotët e filit?".

Ngjarja e madhe kur Ebreheja erdhi për të pushtuar dhe shkatërruar Qaben e Madhërueshme, sepse kishte ndërtuar

një të ngjashme me të, me pretendimin e tij se do ishte pikë referimi për njerëzimin në perandorinë e tij në Jemen. Allahu (xh.sh) e shkatërroi me diçka krejt të papërfillshme dhe u bë viti i filit (elefantit) pikënisje për kalendarin dhe për regjistrimin e historisë).

Pastaj myslimanët morën si pikë referimi për historinë e tyre, hixhretin e Pejgamberit (a.s)! Dhe, teksa vjen data 1 Muharrem, ne patjetër që rikthehemi me vëmendjen tonë dhe me ligjërimet tona rreth hixhretit, emigrimit të madh të Pejgamberit (a.s) nga Meka në Medinë, edhe pse ai nuk ka ndodhur në këtë muaj! E sado që të flasim për të, nuk i japim hakun, sepse patjetër që është një shkollë shumë e madhe, që siç thonë dijetarët tanë, është ngjarja që ndryshoi rrjedhën e historisë së njerëzimit.

E dyta, hixhreti në vetvete, çfarë të them për hixhretin? Tre-katër pika të vogla.

- E para, është një moment reflektimi për mbarë ymetin islam rreth detajeve, rreth personazheve dhe rreth rezultateve.

Detajet, personazhet, rezultatet!

Detajet: Pse ishte emigrimi i Pejgamberit (a.s) nga Meka në Medinë?

Allahu (xh.sh), që i dhuroi Pejgamberit tonë (a.s) Isranë dhe Miraxhin, a nuk mund ta linte Pejgamberin në Mekë, dhe t'ia pastronte krejt kundërshtarët e tij?

Pse të emigronte Pejgamberi në Medinë? Pse të rropatej e të lodhej?

Sa e lodhshme është ajo rrugë me makinë sot! Sa e thatë është ajo shkretëtirë! Sa e lodhshme është pamja e saj dhe, Pejgamberi ta bënte atë rrugë në këmbë dhe me një stërmundim të jashtëzakonshëm!

Është një mësim shumë i madh për t'ju thënë se ky Islam është praktik. Ky nuk është Islami i ëndrrave dhe i lutjeve duke fjetur dhe duke gërhitur ditë e natë! Për këtë, ne nuk pajtohemi me të gjithë ata që thonë sot për dikë, se ky është *njeri i shenjtë* dhe ky njeri me dua (lutje) i kryen punët!?

Po të ishte kryerja e punëve me gisht, nuk do të ekzistonte fare hixhreti! Po të ishte kryerja e punëve në Islam me gisht, nuk do të kishim hixhretin e parë të myslimanëve drejtë Habeshesë!

Ky është Islam i punës, i lodhjes, i sakrificës. Ky është Islami i atij ajeti, të cilin e lexojmë çdo ditë të xhuma në suren El-Kehf.

Allahu (xh.sh) i dha Dhulkarnejn krejt aftësinë dhe forcën për të ndërtuar dhe për të ecur përpara dhe ai i ndoqi shkaqet drejt suksesit! Megjithatë nuk fjeti dhe nuk tha: "Unë kam çdo gjë në dorë"!?

Shihni të madhin Sulejman (a.s), të cilit Allahu (xh.sh) i dha pushtet sa askujt tjetër në botë!

Në një moment të caktuar, çfarë thotë? Kujtoni suren En-Neml, në suren e buburrecës. Ku është hud-hudi¹, ku është hud-hudi, zogu i bukur dhe i vogël? Ku është hud-hudi? A ka munguar? Mungesë pa justifikim! Do ta ndëshkoj me një ndëshkim shumë të rëndë, do ta bëj kurban e do t'ia pres kokën ose do të më sjellë një argument

TEKSA VJEN DATA 1 MUHARREM, NE PATJETËR QË RIKTHEHEMI ME VËMENDJEN TONË DHE ME LIGJËRIMET TONA RRETH HIXHRETIT, EMIGRIMIT TË MADH TË PEJGAMBERIT (A.S) NGA MEKA NË MEDINË, EDHE PSE AI NUK KA NDODHUR NË KËTË MUAJ! E SADO QË TË FLASIM PËR TË, NUK I JAPIM HAKUN, SEPSE PATJETËR QË ËSHTË NJË SHKOLLË SHUMË E MADHE, QË SIÇ THONË DIJETARËT TANË, ËSHTË NGJARJA QË NDRYSHOI RRJEDHËN E HISTORISË SË NJERËZIMIT.

të fortë pse ka munguar. Ai nuk vonoi dhe erdhi, bile solli dhe një lajm për të cilin ti nuk ke dijeni dhe po të tregoj për një lajm nga mbretëria e Sebes, mbretëria e Belksit!

Islami është i punës, i lodhjes, i sakrificës, i shkuarjes, i ardhjes. Mirëpo, ne Kur'anin e lexojmë në mënyrë sipërfaqësore! E ku jemi ne, ku jemi ne?!

Ne jemi akoma te çështjet "madhore", të fërkojmë këpucën, a të fërkojmë çorapin! Ne jemi akoma, a të qethim kokën, a të rrujamë kokën në Haxh...!?

Hixhreti, të dashurit e mi, do të thotë se myslimani nuk bie kurrë! Ne jemi përherë ymet i shpresës dhe i frymëmarrjes, ne nuk biem pa frymë asnjëherë!

Ne kemi mbi njëqind vite që kemi

1. Kurani, En-Neml: 20.

rënë!! Ne po ringrihem, do të jemi brezi i rimëkëmbjes, ndërsa ju, të dashur fëmijët e mi, ju duhet të jeni krenarë se jeni brezi i rimëkëmbjes së vlerave të Islamit, i atij Islami që do Pejgamberi (a.s), jo furrat e atyre, që përgatitën atë që ndodhi para njëqind viteve!?

Ky Islam është i rimëkëmbjes, i forcës, i pushtetit, i të mirës e i çdo mirësie për çdo njeri dhe çdo gjë në rruzullin tokësor, i mëshirës për çdo gjë dhe çdokënd!

- E dyta, Medina e Ndriçuar, e cila është simboli i tubimit të bashkuar të të gjithë myslimanëve përreth Pejgamberit (a.s), si dhe momenti i parë i shfaqjes së munafikëve (hipokritëve)!

Pse në Medinë munafikët dhe jo në Mekë?

Në Medinë, sepse aty është organizimi, është tubimi i shtetit islam në plotkuptimin e fjalës. Aty është vlera e organizimit të myslimanëve!

Largohu paksa nga kjo dhe pyet: A e praktikojmë ne sot hixhretin në xhamitë tona?

A e praktikojmë ne sot Medinën e Ndriçuar në xhamitë tona? A e praktikojmë ne Medinën e Ndriçuar dhe frymën e hixhretit në Myftininë tonë si qytet dhe si zonë? Po në komunitetin tonë, në rang kombëtar dhe në rang të trojeve shqiptare?

Këtu do të ndalem se nuk sosi dot pastaj!

Meka! Pikërisht në Mekë u ndërtua individi, në Medinë shoqëria e vlerave islame, ndërtimi i shtetit islam.

Falë hixhretit, u dëshmuar aftësia e myslimanëve për të jetuar në harmoni dhe plot dinjitet në një shoqëri plotë diversitet. Këtu shohim atë burrë të madh dhe të pa përsëritshëm në historinë e njerëzimit, atë lider të papërsëritshëm, atë pejgamber të papërsëritshëm, Hz. Muhammedin (a.s), që nënshkruan paktin e Medinës midis hebrevë/jehudive të Medinës, me të drejta të barabarta për të ruajtur atë që quhet harmonia kombëtare!

Pakti i Medinës dhe aftësia e myslimanëve në ata kohë, vjen edhe si një thirrje për të sotmen! Sepse ne jemi pasues të frymës së Paktit të Medinës, por jemi dhe të dinjitetit për të mos toleruar pabesinë dhe thikën pas shpine!

3

- **Pika e tretë dhe e fundit**, me të cilën do të përfundoj hytben e kësaj xhumaje: hajduti i Habeshesë.

Imam Bejhakui, transmeton se Hz. Abdullah ibn Mes'udi (r.a), kur së bashku me një grup të caktuar të besimtarëve emigroi drejt Habeshesë, Etiopisë së sotme, me urdhër të Hz. Muhammedit (a.s) shkoi atje dhe nuk fjeti! U stacionua në një vend, mori një shtëpi me qera, jetoi diku, kishte ca para me vete dhe nisi të bënte shitblerje. Një nga komshinjtë i tha të kishte kujdes kur të shkojë për të shitur, sepse ishte një person (dhe ia përshkroi atë me disa veçori që kishte).

Thotë Hz. Abdullahu (r.a): "Shkova në treg dhe u ruajta që ta shoh dhe të ruhem nga ai, dhe e pashë diku. Ngado që e shihja devijoj rrugën dhe rrija në grup me njerëz. Në një moment shita sa shita, grumbullova dy dinarë dhe krejt i hutuar m'u shfaq përpara syve të mi dhe më tha:

- Çfarë ke me vete?

I thashë: - Të lutem! - kam vetëm dy dinarë!

Më tha: - Shtoji!

- Nuk kam vetëm se dy dinarë, t'i jap dhe më lër rahat!

- Shtoji-shtoji! - tha, dhe në këtë moment u shfaqën dy djem të rinj, që vrapuan drejt meje dhe nga frika, ai u largua. I thashë: Ndalun dalun, se t'i kam dhënë ato dy dinarë!

- Nuk kam nevojë për to! - thirri dhe u largua...

Pse e përmendim këtë ngjarje sot?

E përmendim këtë ngjarje sot në prag të hixhretit të ri dhe vitit të ri kalendarik, duke parë se si kemi shumë nevojë për të qenë komshinjtë të mirë për dikë dhe të mos bëhet besëprerë muslimani për hatër të askujt në botë!

E them këtë se kemi nevojë të ruhem nga të bërit keq në shoqërinë tonë, duke u nisur nga shtëpia e jonë, nga xhamia e jonë..!

E thashë edhe në dersin e xhumasë, të mos jemi arrogantë në xhami, mos të jemi xhahilë në xhami, duke nisur me imamin, me muezinin, me shoqërinë, me vëllazërinë!

Të jemi gjithmonë me fytyrë të qeshur e me njet të pastër, me dashamirësi, duke mos futur hundët ku nuk duhet dhe duke mos u marrë më çfarë nuk i takon asnjërit nga ne.

Të dashurit e mi, kemi nevojë të jemi gjithmonë mirëbërës dhe përkrahës të atij që është në hak. Kemi nevojë të jemi në krah të atij që i është bërë padrejtësi.

Shikoni sot, valën e emigrimit mbi dhjetë vite e më tepër, të sirianëve, në veçanti të atyre bashkëvëllezërve të mi, bukën e të cilëve e kam ngrënë unë e sa e sa dhjetëra e dhjetëra prej të nderuarvë, që predikojnë sot, vlerat e Islamit. Bukën e njerëzve më të qytetëruar, që spikasin për të gjitha vlerat, për harmoninë, për tolerancën, për njerzillëkun.

Shikoni se me çfarë përballen!

Jo vetëm me keqbërësinë e pabesinë, por me veset më të liga që janë parë

ndonjëherë në historinë e racës njerëzore nga banorët e këtij kontinenti që quhet Evropë, nga komshinjtë atje në jug që i shkatërrojnë dhe i mbysin varkat a gomonet e tyre, që i lënë pa ngrënë, që i keqtrajtojnë në dimër dhe në verë.

Kemi nevojë të kuptojmë thirrjen dhe ngjarjen e hajdutit të Habeshesë, për t'u distancuar nga e keqja dhe për të thënë: *unë nuk jam hajdut dhe unë nuk jam i pabesë, nuk jam i pamëshirshëm, nuk jam i panjerëzishëm!*

Unë jam musliman! Unë jam njeri i vlerave dhe përkrahës i të mirave. Unë jam ai që i zgjas dorën atij që ka nevojë dhe nuk e la të mbytet e të vdesë për kafshatën e bukës, e jo më ta çoj drejt vdekjes, drejt dëshpërimit me dëshirën time dhe vullnetin tim. Ai që e bën këtë është i lig, ai që e bën këtë nuk ka lidhje me njerzillëkun! Ai që e bën këtë, (që na dhemb zemra për ata fëmijë të vdekur brigjeve të deteve tona), është turpi më i madh i historisë së njerëzimit, prej të cilit ne ndahemi dhe nuk kemi asnjë lidhje! Për të cilin lutemi me zemër që Allahu (xh.sh) ta kthejë dhe ta bëjë njeri, qoftë fillimisht edhe në nivelin e Kabilës, më i keqi i racës njerëzore! Këta as kabilë nuk janë, se Kabili mendoi e mendoi dhe e vrau vëllanë pas shpine! Ndërsa këta janë më të këqinj!

Me zemër të mirë e bekime Vitin e ri 1444!

*Hytbeja e xhumasë
e mbajtur në Parrucë, më 29.7.2022*

Diktoi tekstin: **Siditë Hafzi**



Suad Arilla
Shkrimtar, gazetar

Mbasi lexon një shkrim të tillë, pyes me vete, pse autori Ben Blushi zgjohet aq herët për të parë këtë larmi ngjyrash, modelesh, formash veshjeje dhe sjelljeje të vajzave muslimane në një festë të tyre, kur ai s'ka të bëjë me arsyen pse festohet?!

Nëse autori Ben Blushi është nisur nga qasja e "kritikut letrar", duke synuar vlerësimin e gjërave me vlerë dhe theksuar pikat e dobëta, duke nxitur ndryshime dhe risi, një besimi fetar nuk mund t'i bëhet kjo. Edhe nëse e marrim si një "vepër", Islami i ka elaboruar brenda vetes zhvillimin dhe kritikën.

Nëse autori Ben Blushi është nisur nga qasja e "kuriozitetit", duke kërkuar të shohë, të gjejë, të ndjejë gjëra që i pëlqejnë, kjo është e dëmshme për komunitetin në tërësi. Kurioziteti vetëm orienton komunikimin në formën e gjetjes së kleçkës dhe nuk lejon të depërtojë përtej kontaktit të parë më të parin, dëgjuarin. Ne duhet të komunikojmë që të kuptojmë, të pyesim që të njohim.

Nëse autori Ben Blushi është nisur nga qasja e "dashamirësit", vlen të theksohen gjetjet që bën në shpalljet e Islamit të ri. Por që të quhesh dashamirës i Islamit, do të thotë që je i mjaftueshëm me atë që ke në dorë dhe mendon-kupton-zbulon se nuk ka nevojë për një version të ri.

Nëse autori Ben Blushi është nisur nga qasja e "reformatorit kulturor", me përmendjen sidomos të veshjeve dhe formave të komunikimit, hapjes ndaj shoqërisë, siç duket nuk shprehet një detaj: ka ndryshim mes veshjes që ofron Islami dhe formave që përmenden në shkrimin e tij, që janë thelbësisht kulturore dhe jo domosdoshmërisht fetare.

Nëse autori Ben Blushi është nisur nga qasja e "parashikuesit", jam i sigurt se po të angazhohet personalisht me krijimin e Islamit të ri, do ia dalë. Veçse

NXITUR NGA SHKRIMI I AUTORIT BEN BLUSHI

pas vetes s'mund të ketë muslimanë, por Libra-rët.

Nëse autori Ben Blushi është nisur nga qasja e "faktuesit", duke përmendur vështirësinë e bashkëjetesës së Perëndimit me Islamin, a mos duhet përmendur edhe bashkëpunimi i Perëndimit me Islamin? Sepse ky fakt nuk mund të anashkalohet vetëm sa për të thënë që qëndron i pari.

Nëse autori Ben Blushi është nisur nga qasja e "feministit", kemi një hapësirë mospërmendjeje me dashje të kontributit të grave dhe vajzave muslimane ndër shekuj. Apo edhe të vajzave sot. E, të mos e bësh këtë, nuk do të thotë që s'ka feminizëm, por sepse feminizmin ia kanë mohuar Islamit, vetë feministat.

Tani, përtej shakasë, pse një shkrim i tillë është i dëmshëm për çdo fetar dhe jo fetar, për çdo lexues të komunitetit ku jetojmë:

- Bëhet shkak për islamofobi. Si e tillë, një komunitet ku në lagje gjen edhe musliman, edhe ortodoks, edhe të krishterë, edhe ateist, duke sulmuar njërin prej tyre mund të krijosh artificialisht iluzione mbizotërimi tek ndonjë tjetër. Duke sulmuar njërin, krijon viktimën dhe dhunuesin e ri, jo islamin e ri. Krijon gjykime dhe paragjykime të reja mbi vajzat dhe gratë që veshin format e përmendura në shkrim: identifikimi i tyre nuk është përmendje për njohje, por për etiketim.

- Duke u përmendur vajzat dhe gratë në shkrim, në mënyrë të tërthortë objektivi janë djemtë dhe burrat, të cilët rrezikojnë të vihen në pozita mbrojtjeje për shkak se u quajtën të dhunshëm, kontrollues, sundues, etj. Pra, është cënuar një komunitet i tërë që ka familje dhe ndihen të rrezikuar, mund të targetohen dhe etiketohen në rrugë, mund të ngacmohen ose neglizhohen për shkak të fesë së tyre dhe mund të bëhen objekt talljeje, ose paragjykimi.

- Nënçmimi i grave muslimane me shprehjen "duke vënë dorën mbi fytyrë apo duke u rruhur nga sikleti" dhe duke vlerësuar vajzat e reje muslimane me shprehjen "Ato janë miqësore, pozojnë duke qeshur, llastohen dhe flasin hapur për raportet e tyre me fenë, me shoqërinë dhe me djemtë." nuk është asnjë tjetër vetëm se një ngacmim me dashje që t'i bashkëngjitet pastaj aluzionit mbi Islamin e Ri. Por unë kam sigurinë që këto vajza që shprehin me figurën e

tyre bukurinë, hijeshinë, feminizmin, kulturën, traditën, nuk janë asgjë më shumë dhe asnjë më pak se sa shqiptare dhe europiane.

- Dy janë format kryesore për të hequr ose prishur mbështjelljen fetare të njerëzve: e para, duke proklamuar idenë e besimit në Zot dhe jo në fe. Pra, duke e marrë fenë si diçka kulturore dhe sociale, por jo domosdoshmërisht domethënëse në njohjen e Zotit. Sot ke shumë njerëz që thonë: "Babën e kam pas musliman-bektashi-katolik-ortodoks-budist-etj, mirëpo unë nuk besoj në fe, por besoj se të gjithë kemi një Zot që na ka krijuar të gjithëve ndonjëse e njohim në forma të ndryshme". E dyta, krijimi i versioneve të reja, si "Islami i ri", "Krishtërimi i Ri" "Budizmi i Ri", etj, etj. Standardi i kësaj qëndron në "përmirësimin" e kushteve, praktikave, rregullave që ofron forma zyrtare e besimit, pra ndryshimin e tyre siç i shkon për shtat praktikuesve, duke anashkaluar Zotin dhe shpalljen e Tij.

- Nëse ndonjë prej miqve të mi të feve të tjera të cilët janë të shumtë, do u ishte bërë një shkrim i tillë, do kisha reaguar duke thënë vetëm kaq: ju dua ashtu siç jeni, ndaj mos bini pre e provokimit. Nëse vërtetë kemi një Zot dhe fetë tona janë forma, metoda, rruga, qasja për të arritur tek Ai, unë s'do doja kurrë që këta miqtë e mi të ndiheshin të detyruar të merrnin një drejtim të ri. Do u thoja: mbajeni fort fenë tuaj, identitetin tuaj, krenarinë që keni për atë që jeni dhe për atë që kanë qenë paraardhësit tuaj dhe për atë që do jenë fëmijët tuaj. Vajzat dhe djemtë e shoqërisë shqiptare ku jetojmë duhet të mbushen me vlera, duhen të kenë në thelb përfshirjen, tolerancën, dashurinë reciproke, pranueshmërinë dhe të jenë rezistent, mospranues, refuzues ndaj kërcënimeve që i vinë së tërës. Ky shkrim pikërisht më duket si një kërcënim që në këtë kohë i ka ardhur së tërës dhe jo vetëm Islamit.

I kam lexuar romanet e autorit Ben Blushi dhe pa asnjë mëdyshje pranoj që është një autor shumë i mire, duke bërë gjetje dhe sjellë risi në letërsinë shqipe. Madje kam ndjekur edhe ecurinë e tij në evente europiane ku është shpallur fitues çmimesh. Mirëpo kështu ai rrezikon të kthehet në një kandidat. Aty ku mosqenia pjell pozicionin. Vetëm kjo qasje e rrezikon të mbahet mend për atë që është paguar dhe jo gatuar.



Lavdrim Hamja
Imam - Xhamia e "Dy Vajzave"

Tregimet më të mira janë tregimet kur'anore, sepse ato mbartin mësim, mesazhe dhe urtësi, që i bëjnë dobi secilit njeri, i cili mediton dhe mendon rreth tyre. Allahu i Madhëruar nuk i ka përjetësuar këto tregime kur'anore thjesht për kënaqësi apo sa për të kaluar kohën çdokush që i lexon, por sigurisht për mësimet dhe mesazhet që mbartin: "Me të vërtetë në tregimet e tyre ka mësim për të zotët e mendjes!" - (Jusuf: 111)

Prej këtyre tregimeve kur'anore është edhe tregimi i banorëve të Shpellës (Es'habul-Kehf), të cilin Allahu i Madhëruar na e ka treguar në fillim e sures me të njëjtin emër, sureja El-Kehf, të cilën Pejgamberi (a.s) na ka nxitur, që ta lexojmë çdo ditë të xhuma, duke thënë: "Kush i mëson dhjetë ajete prej fillimit të sures El-Kehf, mbrohet prej dexashtetë" dhe në një transmetim tjetër: "Prej fundit të sures El-Kehf!" - (Muslimi)

"Kush e lexon suren El-Kehf (siç ka zbritur), do të ketë dritë në ditën e kiametit, nga vendi i tij deri në Mekë; dhe kush i lexon dhjetë ajetet e fundit të saj, pastaj del dextali, nuk ka për t'i bërë dëm..." - (Sahih)

"Kush e lexon suren (El-Kehf) ditën e xhuma, e ndriçon një dritë mes dy xhumave" - (Sahih Et-Tergib vet-Terhib)

I gjithë Kur'ani Famëlartë është fjala e Allahut dhe tërë fjalët e Tij janë të madhnueshme, të larta, të mira dhe kanë të njëjtën pozitë. Megjithatë, i Dërguari i Allahut (a.s) na ka treguar për disa sure apo ajete, të cilat kanë vlera të veçantë në leximin e tyre në ditë apo kohë të veçantë.

Edhe pse hadithet për vlerën e veçantë të disa sureve nuk janë të shumtë, madje ka shumë abuzime në lidhje me këtë fushë, transmetohen

TË RINJ TË PËRJETËSUAR NË SUREN EL-KEHF

hadithe për disa sure apo ajete të Kur'anit Famëlartë. Në mesin e këtyre sureve është edhe sureja El-Kehf, rreth të cilës janë transmetuar disa hadithe, që sapo i përmendëm.

Tregimi i banorëve të Shpellës (Es'habul-Kehf) me gjithë çudinë dhe mahninë e këtij tregimi, nuk është prej ajeteve më të mahnitshme, siç thotë edhe Vetë Allahu i Madhëruar në këtë sure: "A mendove se banorët e Shpellës dhe të Rrekimit¹, janë prej ajeteve Tona më të mahnitshme!" - (El-Kehf: 9)

E megjithatë, tregimi dhe historia e banorëve të Shpellës mbart në vetvete mësim dhe mesazhe të mrekullueshme për këdo, veçanërisht për djemtë e rinj, siç ishin edhe vet këta banorë.

SI ËSHTË HISTORIA E TYRE?

Shkurtimisht, historia e banorëve të Shpellës, të cilën e përmendim librat e Tefsirit, është e tillë: Një mbret diktator, i quajtur Dekjanos, që sundonte një vendbanim romak, të quajtur Tartus, pas periudhë së Isait (a.s). Ai i bënte thirrje njerëzve të adhuronin idhujt, dhe çdo besimtar që e kundërshtonte dhe nuk pranonte thirrjen e tij për të adhuruar idhujt, e vraste.

Kjo sprovë filloi të përhapej dhe përfshiu tërë besimtarë e atij vendi. Ky grup i të rinjve, kur e panë këtë gjë, u hidhëruan shumë dhe lajmi i tyre i mbërriti mbretit diktator. Ai dërgoi njerëz për t'i sjell përpara tij. Kur i sollën, ai i kërcënoi me vrasje, nëse nuk adhurojnë idhujt dhe nuk sakrifikojnë për to. Djemtë e rinj qëndruan të palëkundur përpara tij dhe i thanë: "Zoti ynë, është Zoti i qiejve dhe i tokës! Nuk do t'i lutemi, asnjë zoti tjetër, përveç Tij" - (El-Kehf: 14)

Ai ua ktheu, duke i thënë: Ju jeni djelmosha të rinj, kështu që do t'ju lë afat deri nesër, që ta shikoni edhe njëherë mendimin tuaj.

Ata u arratisën natën dhe rrugës panë një çoban së bashku me qenin e tij, e ai u bashkua atyre. Në mëngjes u futën në shpellë dhe mbreti e ushtria e tij i ndoqën. Kur arritën tek shpella, ata u frikësuan dhe u tmerruan, e nuk hynë në shpellë. Mbreti i tha, që t'i mbyllën derën e shpellës, deri sa të vdesin në të

nga etja dhe uria!

Allahu i vuri në gjumë banorët e Shpellës, dhe ashtu qëndruan në gjumë pa e ndjerë kalimin e kohës, 309 vjet!

Pastaj, Allahu i zgjoi dhe ndërkohë ata menduan se kanë fjetur një ditë apo një pjesë të ditës. Kishin uri, kështu që dërguan njërin prej tyre për të blerë ushqim, por e porositën që të fshihet dhe të bëjë shumë kujdes, në mënyrë që të mos bie në sy. Arriti në qytet dhe pa se gjërat kishin ndryshuar dhe nuk ishin siç i kishin lënë më parë. Nuk njohu askënd prej njerëzve. Me vete tha: Ndoshta kam ngatërruar rrugë. Bleu disa gjëra dhe kur i dha monedhat shitësit, ai filloi t'i rrotullonte dhe tha: Ku i ke marrë këto monedha?

I GJITHË KUR'ANI FAMËLARTË ËSHTË FJALA E ALLAHUT DHE TËRË FJALËT E TIJ JANË TË MADHNUESHME, TË LARTA, TË MIRA DHE KANË TË NJËJTËN POZITË. MEGJITHATË, I DËRQUARI I ALLAHUT (A.S) NA KA TREQUAR PËR DISA SURE APO AJETE, TË CILAT KANË VLERA TË VEÇANTË NË LEXIMIN E TYRE NË DITË APO KOHË TË VEÇANTË.

Njerëzit filluan të mblidhen dhe shikonin me habi monedhat, pastaj i thanë: Kush je ti, o djalosh? Ndoshta ke gjetur ndonjë thesar?

Ai ua ktheu: Jo, pasha Allahun, nuk ka gjetur asnjë thesar, këto janë monedhat e popullit tim!

Ata i thanë: Këto janë që në kohë të largëta, që nga koha e mbretit Dekjanos.

Ai tha: Çfarë ka ngjarë me Dekjanosin?

I thanë: Ka disa shekuj që ka vdekur!

Tha: Pasha Allahun, askush nuk më beson çfarë po them: Ne jemi disa djem të rinj, ku mbreti nga detyroi të adhuronim idhujt, por u arratisëm prej tij, që mbrëmë dhe zumë vend në shpellë. Shokët më dërguan sot të blej ushqim. Ejani me mua tek shpella dhe t'ju tregoj shokët.

Ata u habitën prej fjalëve të tij dhe njoftuan mbretin, i cili ishte besimtar

i devotshëm dhe kur dëgjoi historinë e tij, doli ai, ushtria dhe banorët e kur shkuan te shpella, shokët e tij dëgjuan hingëllimat e kuajve dhe zërat e njerëzve dhe menduan se janë njerëzit e Dekjanos-it, e kështu filluan të falen.

Mbreti hyri në shpellë dhe i pa duke u falur. Kur mbaruan nga namazi, ai i përqafoi dhe u tregoi se ishte besimtar dhe se Dekjanos-i kishte kohë që ishte zhdukur. Ai dëgjoi tregimin dhe historinë e tyre dhe kuptoi, se Allahu i kishte ngjallur, në mënyrë që ata të ishin argument për njerëzit.

Pastaj, Allahu i vuri përsëri në gjumë dhe ua mori shpirtrat. Njerëzit filluan të thonë: Le ta bëjmë xhami vendin e tyre!

Kështu, Allahu i Madhëruar e përjetësoi tregimin dhe historinë e tyre në suren El-Kehf.

Nuk ka dyshim, që kjo histori mbart me vete shumë mesazhe dhe mësim, le të ndalemi shkurtimisht tek disa prej tyre:

1. Besimi i drejtë në një Zot të Vetëm, edhe pse shumica e njerëzve, adhurojnë idhuj apo diçka tjetër, përveç Allahut: "Ata ishin një grup të rinj, që besuan Zotin e tyre dhe Ne u shtuam udhëzim". - (El-Kehf: 13)

2. Qëndrimi i palëkundur në besim dhe shpalosja e tij përpara kujtdo, veçanërisht përpara sundimtarëve zullumqarë: "Ua forcuam zemrat e tyre, ndërkohë që u ngritën dhe tanë: Zoti ynë, është Zoti i qiejve dhe i tokës! Nuk do t'i lutemi, asnjë zoti tjetër, përveç Tij.

Atëherë, ne do të thonim padrejtësisht (do të bënim zullum)!" - (El-Kehf: 14)

3. Kur mbajtja e besimit bëhet e pamundur në një vend dhe ke frikë se banorët e atij vendi do të detyrojnë të mohosh besimin dhe fenë, atëherë largohu prej aty dhe emigro, e shko në një vend të sigurt ku ta adhurosh Allahun dhe ta mbash besimin e drejtë: "Zoti ynë, na dhuro prej Teje mëshirë dhe na jep udhëzim (mbarësi) në këtë çështje!" - (El-Kehf: 10)

4. Kush është i singertë me Allahun, Allahu do t'i pranojë singëritetin e tij dhe do t'i japë mbarësi e sukses, mbrojtje e furnizim, nga nuk e pret dhe as nuk i shkon në mendje. Allahu i mbrojti kur ishin të zgjuar (gjallë) dhe i mbrojti edhe kur ishin fjetur, në gjumë: "E, i rrotulloni djathtas e majtas, ndërkohë qeni i tyre kishte shtrirë këmbët në fund (të shpellës). Sikur t'i shihje ata, do të kishe ikur prej tyre dhe do të ishe tmerruar!" - (El-Kehf: 18)

Në librat e tefsirit tregohet se kushdo që mendohej t'i afrohej shpellës, frikësohej dhe largohej i tmerruar prej aty, dhe kështu banorët e Shpellës flinin të patrazuar!

5. Mirësia e shoqërisë së mirë. Edhe qeni, që u shoqërua me ta, fitoi prej bekimit të këtyre djemve të rinj të përkushtuar, dhe qëndroi në gjumë e u përjetësua edhe ai me ta. Në një hadith të gjatë, Pejgamberi (a.s) duke treguar për mirësinë e hallkave të mira, të dhikrit, thuhet: "Një melek prej

melekëve thotë: Aty ndodhet edhe filani, që nuk është prej tyre, por ka ardhur për një nevojë të tij. Tha: "Ata janë kuvendues, që nuk dëshpërohet me ta, kuvenduesi i tyre!" - (Buhariu)

Ose në një hadith tjetër: "Njeriu është në fenë e shokut të tij, prandaj le të shikojë secili prej jush, se me kë shoqërohet!" - (Imam Ahmed, Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe Bejhakui)

6. Të ushqyerit hallall. Edhe pse jeton në një vend tjetër, që nuk e njeh mirë, ti duhet të kujdesesh, që ushqimi yt të jetë i pastër dhe hallall: "Le të shikojë, se cili ushqim është më i pastër, e t'ju sjellë furnizim prej tij..." - (El-Kehf: 19)

7. Lutja drejtuar, vetëm Allahut e askujt tjetër. Sado që je në vështirësi dhe sado që të kesh situata të vështira, askujt mos iu drejto për lutje, përveç Zotit të gjithësisë, Ai është, i Cili i përgjigjet lutjes së nevojtarit: Nuk do t'i lutemi, asnjë zoti tjetër, përveç Tij. Atëherë, ne do të thonim padrejtësisht (do të bënim zullum)!" - (El-Kehf: 14)

Historitë e Kur'anit Famëlartë janë burim frymëzimi dhe besimi. T'i lexojmë me vëmendje dhe të meditojmë rreth tyre; të nxjerrim mësimet dhe të përfitojmë prej tyre duke gjetur frymëzim dhe mbështetje, sepse siç thotë Allahu i Madhëruar: "Me të vërtetë në tregimet e tyre ka mësim për të zotët e mendjes!" - (Jusuf: 111)

"Tregoi tregimet, ndoshta ata meditojnë (mendojnë)!" - (El-Araf: 176)

"Njeriu është në fenë e shokut të tij, prandaj le të shikojë secili prej jush, se me kë shoqërohet!"



Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Fjala “Sadaka” rrjedh nga fjala “Sidk” që do të thotë sinqeritet, vërtetësi. Besimtari e vërteton besimin e tij, duke dhënë për hir të Allahut dhe për të fituar kënaqësinë e Tij pa lakmuar ndonjë shpërblim nga njerëzit.

VLERA E SADAKASË NË KURAN

1. Sadakaja e pastron njeriun nga gjynahet. Allahu (xh.sh) thotë: “Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t'i pastrosh ata...”¹

2. Allahu i Madhëruar i nxit besimtarët për të dhënë sadaka. Allahu (xh.sh) thotë: “O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që Ne ju kemi dhënë”.²

3. Përkushtimi i vërtetë arrihet atëherë kur besimtari jep sadaka nga ajo që e do më shumë. Allahu (xh.sh) thotë: “Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni”.³

4. Pasuria shtohet me dhënien e sadakasë. Allahu (xh.sh) thotë: “Sa herë që shpenzoni diçka për bamirësi, Ai ua zëvendëson atë dhe jua shumëfishon.”⁴ Për këtë arsye, Profeti (a.s) u thoshte besimtarëve: “Nuk pakësohet pasuria e atij që jep lëmoshë!”⁵

VLERAT E SADAKASË NË HADITHE

1. Ajo që jepet sadaka, mbetet tek Allahu i Madhëruar. Pejgamberi (a.s) e pyeti Aishen (r.anha) në lidhje me një qengj që kishin prerë dhe që ia

1. Kur'ani, Et-Teube: 103.
2. Kur'ani, El-Bekare: 254.
3. Kur'ani, Ali-Imran: 92.
4. Kur'ani, Sebe: 39.
5. Transmeton Muslimi.

VLERA E SADAKASË

Hz. Omeri (r.a) ka thënë:

“Veprat e mira mburren me njëra tjetrën, ndërsa sadakaja thotë: “Unë jam më e mira në mesin tuaj”

kishte lënë asaj për ta dhënë sadaka: Çfarë ka mbetur prej tij”? Ajo ishte përgjigjur: “S’ka mbetur asgjë, përveç një shpatulle”. Pejgamberi (a.s) tha: “Ka mbetur e gjitha, përveç shpatullës”.⁶

Tregohet se Aishja (r.anha) para se të jepte sadaka, e merrte monedhën dhe e parfumonte atë. Kur e pyetën përse e bënte këtë gjë, ajo tha: “E bëj pasi ajo do të bjerë në dorë të Allahut, para se të bjerë në dorën e të varfrit”.



Nuk pakësohet pasuria e atij që jep sadaka!

2. Melekët lutën për atë që jep sadaka. I Dërguari i Allahut ka thënë: “Në mëngjesin e çdo dite, dy melekë zbresin (nga qielli). Njëri prej tyre thotë: “O Allah! Jepi atij që jep”, ndërsa tjetri thotë: “O Allah! Mos i jep atij që nuk jep”.⁷

3. Sadakaja e shuan zemërimin e Allahut. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Nuk ka dyshim, se sadakaja e shuan zemërimin e Allahut”.⁸

4. Sadakaja shëron të sëmurët. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Shëroni të

6. Transmeton Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi.
7. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.
8. Transmeton Taberani në Kebir dhe në Evsat, Hejthemiu në Mexhmauz’ zevaid, 3/115.

sëmurët tuaj me sadaka”.⁹

5. Sadakaja e zbut zemrën nga ashpërsia. Ebu Hurejra (r.a) tregon, se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Nëse dëshiron që të zbutet zemra, ushqe të varfrin dhe fërko kokën e jetimit”.¹⁰

6. Sadakaja është nga veprat më të dashura tek Allahu i Madhëruar. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Vepra më e dashur tek Allahu është gëzimi, që (një besimtar) fut në zemrën e një besimtari (tjetër). Kjo gjë arrihet, duke i larguar besimtarit një shqetësim, ose duke i larguar atij urinë, ose duke i shlyer borxhin”.¹¹

7. Shpërblimi i sadakasë nuk ndërpritet me vdekjen e personit që e ka dhënë atë. Ebu Hurejrah (r.a) tregon, se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kur njeriu vdes, i ndërpritet (shpërblimet e) të gjitha punët, përveç tre prej tyre: lëmosha e rrjedhshme (vakëfet, ndërtimi i një çezme, etj), dituria prej të cilës kanë dobi njerëzit dhe një fëmijë i mirë, i cili lutet për të”.¹²

8. Sadakaja e shuan zjarrin e xhehenemit.¹³ Në një hadith tjetër thuhet: “Nuk ka njeri që nuk do të qëndrojë përpara Zotit për t’u marrë në pyetje. Zoti i gjithësisë do ta pyesë, ndërkohë që në të djathtën e tij do të jetë xheneti dhe në të majtë xhehenemi. Prandaj, ruajuni nga zjarri i xhehenemit duke dhënë qoftë edhe një gjysmë hurme.”¹⁴ Pra, mund të bëhet shkak një gjysmë hurme që ti të shpëtosh në botën tjetër.

9. Sadakaja është shkak për largimin e sprovave dhe fatkeqësive. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Allahu e porositi

9. Transmeton Taberani në Kebir dhe Sagir, Ebu Davudi në Merasil dhe Bejhakui në Shuab.

10. Transmeton Imam Ahmedi.

11. Et-Tergib vet’terhib.

12. Transmeton Muslimi dhe Buhariu në Edebul’mufred.

13. Transmeton Tirmidhiu.

14. Transmeton Muslimi.

Jahjanë, të birin e Zekerijas (a.s) me pesë porosi që t’i zbatojë dhe gjithashtu t’i urdhërojë edhe Beni Israilët që t’i zbatojnë ato: (ndër të tjera) tha: Ai ju ka urdhëruar për sadaka. Shembulli i sadakasë është si shembulli i një personi të cilin armiku e ka zënë rob dhe kërkon ta ekzekutojë, atëherë i robëruari thotë: Jam i gatshëm të jap si kompensim çdo gjë që posedoj të vogël dhe të madhe. Në këtë mënyrë arrin të shpëtojë veten e tij prej tyre”.¹⁵

Ibn Kajjimi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Sadakaja ka ndikim të çuditshëm në largimin e sprovave, edhe sikur ajo të jepet nga një njeri i keq dhe zullumqar, madje edhe nga qafiri”.¹⁶

Umer ibn Hattabi (r.a) ka thënë: “Veprat e mira mburren me njëra tjetrën, ndërsa sadakaja thotë: “Unë jam më e mira në mesin tuaj”.¹⁷

Ibn Mesudi (r.a) ka thënë: “Nëse dëshiron që ta ruash thesarin tënd aty ku nuk ta vjedh asnjë hajdut dhe nuk do të prishet kurrë, atëherë jepe sadaka”.¹⁸

Sufjan Theuriu, (mëshira e Allahut qoftë mbi të) kur dikush i kërkonte diçka, i thoshte: “Mirë se erdhe, o ti që Zoti të bëri shkak që të fitoj sevapel!” Shiko se si e konsideronin sadakanë të parët tanë të mirë! Një tjetër nga të parët shprehej: “Mirë se erdhe, ti që do ma kalosh mallin për në botën tjetër pa pagese!”

Në mënyrë që t’i fitojmë të gjitha këto mirësi që ka sadakaja duhet që t’i kemi parasysh këto gjëra:

1. Sadakaja duhet që të jepet me sinqeritet dhe për hir të Allahut të Madhëruar.

2. Sadakaja nuk duhet që të jepet me mendjemadhësi dhe arrogancë. Nuk duhet të shkelet dinjiteti i fukasë, të nënçmohet dhe të përbuzët ai.

3. Nuk duhet që të përmendet sadakaja e dhënë.

4. Menaxhimi siç duhet i pasurisë do të na japë mundësinë që ta ndajmë atë edhe me të tjerët.

5. Sigurohu që atij që ia jep sadakanë të jetë me të vërtetë nevojtarë.

I lutemi Allahut të Madhëruar që të na bëjë edhe neve prej atyre që japin nga ajo që Allahu i Lartësuar u ka dhënë atyre.

15. Transmeton Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi.
16. Shih librin e autorit me titull “El-Vabil es-Sajjib”, f.31.
17. Transmeton Ibn Khuzejmeh dhe Hakimi.
18. Hiljetul-Evlja, 1/135.

ALLAHU I MADHËRUAR NA KA DHURUAR NJË VEND TË BEKUAR, QË ËSHTË MË I ÇMUAR SE NAFTA!

Princi i kurorës së Arabisë Saudite, Muhamed ibn Selman, është shprehur:

Ne me bindje besojmë dhe e dimë mirë, se Allahu i Madhëruar na ka dhuruar një vend të bekuar, që është më i çmuar se nafta; në të janë Dy Xhamitë e Shenjta (Qabja e bekuar dhe xhamia e Pejgamberit (a.s), toka më e dëlirë mbi sipërfaqen e tokës; kibleja (drejtimi) i një miliard e më shumë muslimanëve.

Kjo është thellësia jonë arabo-islame dhe faktori jonë i parë i suksesit!

(burimi, twitter: @ajelnews24)



Qabja e Bekuar



Medina e Ndrëquar



NË SHKODËR, FESTOHET ME MADHËSHTI KURBAN BAJRAMI!

Ditën e shtunë, më 9 korrik 2022, në sheshin bri xhamisë së madhe, "Ebu Bekër", u zhvillua ceremonia e faljes së Kurban Bajramit, më një pjesëmarrje madhështore të mijëra besimtarëve të qytetit të Shkodrës.

Pas faljes së namazit të sabahut, imamët dhe teologët, Durim Kasemi, Lavdrim Hamja dhe Arben Halluni mbajtën kumtesa si dhe dhanë mesazhe mjaft të rëndësishme për festën e Bajramit, ngjarjet që lidhen me këtë ditë të madhe të besimit dhe adhurimit si dhe

për simbolikën e Kurban Bajramit, që manifeston sakrificën, heroizmin dhe bindjen ndaj Zotit Fuqiplotë.

Më pas u bë falja e namazit të Kurban Bajramit si dhe mbajtja e hytbes nga teologu Idmir Plaku, i cili krahas mesazheve të vyera bëri thirrje për unitet, paqe dhe harmoni në mes të gjithë njerëzve dhe krijesave të Zotit në tokë.

Ky manifest i madh islam u mbyll me urime dhe përgëzimi të festës së Kurban Bajramit në mesin e besimtarëve.



KIRGISTANI

Kirgistani, ose zyrtarisht 'Republika e Kirgistanit', është një vend i Azisë Qendrore që nuk ka dalje në det.

Kirgistani kufizohet me Kazakistanin në veri, me Kinën në lindje, me Taxhikistanin në jug dhe me Uzbekistanin në perëndim. Kryeqyteti dhe qyteti më i madh i vendit është Bishkek.

Kirgistani ka një sipërfaqe prej 199.951 km², dhe një popullsi prej 6.748.163 banorësh (korrik 2022, sipas worldometers.info).

GJEOGRAFIA

Kirgistani është një vend kryesisht malor. Në skajin e tij lindor, pranë rajonit autonom Ujgur të Sinkiang-ut (në Kinë), ngrihet maja Viktori (Victory), me 7.439 metra, që është edhe maja më e lartë e Kirgistanit. Në kufi me Kazakistanin gjendet mali Khan-Tengri, i cili është afërsisht 6995 metra i lartë. Këto male qëndrojnë në zemër të vargmalit malor Tien Shan, i cili vazhdon drejt lindjes në Kinë. Në kufirin jugor të vendit shtrihen vargmalet Kok Shaal-Tau, Alej, Trans-Alej dhe Atbashi.

Në jugperëndim të vendit gjenden dy lugina të mëdha, lugina e Ferganës dhe një luginë tjetër afër malit Khan-Tengri. Kjo lugina e fundit kufizohet nga vargmalet Kungej-Alatau dhe Terskej-Alatau, dhe përmbajnë liqenin Issyk-Kyl, ujërat e thella dhe të kthjellëta, që burojnë nga majat e maleve të mbuluara me borë.

Struktura e thyer malore që karakterizon pjesën më të madhe të vendit, dhe rrafshnalta e lartë alpine e rajoneve qendrore dhe lindore, ndahen nga Lugina e Ferganës në perëndim nëpërmjet vargmalit Fergana, që shtrihet nga juglindja në veriperëndim, dhe që shkrihet në vargmalin Çatkal. Vargmali Çatkal është i lidhur me rajonin Isyk-Kyl nga një vargmal final përmbyllës, vargmalin Kirgiz.

Të vetmet ultësira të tjera të rëndësishme në vend janë luginat e lumenjve Çu dhe Talas në veri, me kryeqytetin Bishkek, që gjendet në luginën e lumit Çu. Zonat fushore të vendit, megjithëse zënë vetëm një të shtatën e sipërfaqes totale, janë vendbanimi i shumicës së popullatës së Kirgistanit.

Kreshtat e vargmaleve të larta malore të Kirgistanit janë të mbuluara vazhdimisht nga bora dhe akulli. Lumi Narin, që derdhet në luginën e Ferganës, vazhdon në veriperëndim si një degë e Sir-Darja. Lumi Çu shkon paralelisht me vijën kufitare me Kazakistanin, dhe është pjesë e kufirit verior. Lumenjtë Çu dhe Narin kanë një rëndësi të madhe për vendin.

KLIMA

Distanca e madhe e Kirgistanit nga oqeanet dhe ndryshimi i mprehtë i lartësisë nga fushat ngjitur, ndikon fuqishëm në klimën e vendit. Shkretëtirat dhe fushat e rrethojnë Kirgistanin në veri, perëndim dhe juglindje, duke e bërë kontrastin me klimën dhe peizazhin e brendësisë së



tij malore edhe më të habitshme. Pjesët e poshtme të vargmaleve shtrihen në breza me temperaturë të lartë, dhe rrahën nga erëra të nxehta dhe tharëse që vijnë nga shkretëtirat matanë. Sasia e reshjeve që marrin shpatet e maleve në vend, nga perëndimi dhe veriu, rritet me rritjen e lartësisë së tyre. Luginat kanë verë të nxehtë të thatë, me një temperaturë mesatare të korrikut prej 28 °C. Në Janar temperatura mesatare atje është -18 °C. Reshjet vjetore variojnë nga 180 mm në Tien Shan-in lindor, në 760 - 1000 mm në vargmalet Kirgistan dhe Fergana. Në luginat që janë më të populluara, reshjet variojnë nga 100 - 500 mm në vit.

GJUHA

Shumica e banorëve të Kirgistanit flasin një gjuhë që i përket grupit veriperëndimor të gjuhëve turke, veçanërisht kirgize. Një pakicë e konsiderueshme flet uzbekisht. Në vend flitet gjithashtu edhe rusisht dhe statusi i gjuhës zyrtare i është dhënë si gjuhës kirgize ashtu edhe rusishtes.

FEJA

Islami është feja mbizotëruese e Kirgistanit. CIA World Factbook vlerëson se qysh nga viti 2017, 90% e popullsisë së Kirgistanit janë myslimanë sunitë, që i përmbahen shkollës Hanefi; 7% e popullsisë janë të krishterë, kurse pjesa tjetër u përkasin feve të tjera.

EKONOMIA

Bujqësia përbën rreth dy të pestat e vlerës së prodhimit ekonomik në Kirgistan. Dhentë janë kafshët më të rëndësishme atje, por rriten edhe lopë, dhi, dhe jakët (kau i tibetit) nëpër male. Kultivimi i kulturave bujqësore është i përshtatshëm në më pak se 10% të sipërfaqes së vendit. Fermerët varen nga ujitja për prodhimin e shumicës së kulturave bujqësore. Prodhimet kryesore në vend janë pambuku, vezët, frutat, gruri, qumështi dhe perimet.

Industria përbën rreth një të tretën e prodhimit ekonomik të Kirgistanit. Produktet kryesore industriale përfshijnë: materiale sintetike, produkte ushqimore, makineri, metale

dhe tekstile, dhe qendra kryesore industriale është Bishkek. Ka një sërë minerale në Kirgistan, përfshirë antimonin, qymyrin, arin, plumbin, merkurin, naftën, uraniumin dhe zinkun.

HISTORI

Historia e Kirgistanit mund të gjurmohet të paktën që nga shekulli i parë p.e.s. Vendbanimet e mundshme të kirgizëve të hershëm kanë qenë në luginën e sipërme të lumit Jenisej të Siberisë qendrore, dhe kultura Tashtik (shekulli I p.e.s.–shek.V e.s.), e krijuar nga një përzierje e popujve aziatikë dhe evropianë, mund të ketë qenë kultura e tyre. Burimet kineze dhe myslimane të shekujve 7-12 të e.s., i përshkruajnë kirgizët si flokëkuq, me ngjyrë të hapur të lëkurës, dhe me sy të gjelbër ose blu. Ata shiheshin si një popull “verior” që banonin në pyll, i cili përdorte ski dhe praktikonte shamanizmin. Në mesin e shekullit të 9-të, kirgizët, deri atëherë me siguri turqishtfolës, përmbysën perandorinë ujgure në Mongoli, por nuk u vendosën atje, por mbetën një ‘popull i pyllit’.

Sipas gjeografisë persiane Hudud El-A'alam (982), kirgizët jetonin në skaj të “Vendeve të pabanuara të Veriut”. Studiuesi i gramatikës i shekullit të 11-të, Mahmud El-Kashghari, përmend se gjuha e tyre ishte turke. Për shkak të habitateve të tyre të izoluara, kirgizët mbetën jashtë rrjedhës kryesore të historisë së Azisë së Brendshme, një fakt që i lejoi ata të mbijetonin nga ‘rrebeshi mongol’, i cili e ndryshoi plotësisht peizazhin politik të Azisë së Brendshme. Në vitin 1207, Kirgistani iu dorëzua djalit të Xhengiz Khan-it, Jochi-t.

XHAMIA AL-SARAKHSI, BISHKEK



KRYEQYTETI, BISHKEK



Kirgistani mbeti nën autoritetin e mongolëve deri në vitin 1758 e.j, kur kirgizët u bënë pjesë e perandorisë Qing (Manchu) të Kinës. Mes viteve 1825 dhe 1830, vendi u pushtua nga Muhamed Ali, khani i Kokandit, dhe Bishkek, kryeqyteti i ardhshëm i Kirgistanit, u ndërtua nga ai khanat.

Në fund të shekullit të 19-të, pjesa lindore e atij që është sot Kirgistani, kryesisht rajoni Issyk-Kyl, iu dorëzua perandorisë ruse nga Kina Qing, nëpërmjet Traktatit të Tarbagatait. Territori, i njohur atëherë në rusisht si “Kirgizia”, u përfshi zyrtarisht në Perandorinë Ruse, në vitin 1876.

Më 31 Gusht të vitit 1991, Kirgistani fitoi pavarësinë nga Bashkimi Sovjetik.

SI ERDHI ISLAMI NË KIRGISTAN

Tashmanbet Kenensariiev, doktor dhe profesor i historisë në Republikën e Kirgistanit, shkruan: “Përhapja e

Islamit në Kirgistan dhe procesi i konsolidimit të tij zgjati rreth 1300 vjet, dhe u shoqërua me ngjarje të mëdha historike të Azisë Qendrore. Deri tani nuk ka qenë e lejuar të studiohet historia e përhapjes së Islamit - një prej feve më të mëdha të botës - në Azinë Qendrore, përfshirë Kirgistanin. Përveç paragrafëve të shkurtër përkatës për Islamin dhe besimet e tjera fetare në tekstet shkollore, nuk ka asnjë kërkim specifik tjetër për përhapjen e Islamit në Kirgistan, në historiografinë e shekujve 18-20.

Gjatë periudhës së pavarësisë së Kirgistanit u kryen studime të shkurtra sipërfaqësore në lidhje me këtë temë, dhe rezultatet e tyre u prezantuan në Bishkek, në konferencat e mbajtura në Osh dhe Xhelal-Abad.

Bazuar në faktet e nxjerra nga hulumtimet e rëndësishme mbi historinë e Islamit dhe ngjarjet e rëndësishme

SHESHI 'TRIUMFI', BASHKEK



politike dhe shpirtërore në historinë e Turkestanit dhe Kirgistanit, procesi i përhapjes dhe konsolidimit të Islamit në Kirgistan mund të ndahet në dy etapa të mëdha. Etapa e parë mund të quhet “etapa e përhapjes së Islamit”. Kjo etapë mbulon të gjithë mijëvjeçarin dhe mbulon shekujt VIII-XVIII të erës sonë, dhe ndahet në katër faza: 1. Faza e parë, e përhapjes së Islamit në territorin e Kirgistanit (shek. VII-X); 2. Faza e njohjes së Islamit si fe shtetërore në rajonin e Kirgistanit (966-1137); 3. Për shkak të ndikimit të ngjarjeve politike në shekujt XII-XVI, erdhi faza e dobësimit të ndikimit të Islamit; 4. Faza në rritje e përhapjes së Islamit në mesin e Kirgizëve (shek. XVI-XVIII).

Është me vend të thuhet që “Etapa e dytë” - nga shekulli i 18-të deri në ditët e sotme - të quhet “etapa e forcimit të Islamit”, dhe të ndahet në 4 fazat që vijojnë: 1. Faza e forcimit të Islamit në rajonet e Kirgistanit (1711-1876), gjatë Khanatit Kokand; 2. Statusi i Islamit në Kirgistan në kuadër të sistemit kolonial rus (nga gjysma e dytë e shekullit të

19-të deri në vitet 20 të shekullit të 20-të); 3. Gjendja islame në Kirgistan gjatë regjimit totalitar sovjetik (1917-1991); 4. Zhvillimi i Islamit gjatë periudhës së pavarësisë së Kirgistanit dhe forcimi i vazhdueshëm i tij nga viti 1991 e deri në ditët e sotme.

Është e pamundur të përshkruhen dy etapat e përmendura dhe katër fazat e tyre në një artikull, prandaj në këtë artikull do të përshkruajmë vetëm një pjesë të fazës së parë (shek. VII-X) të përhapjes së Islamit në territorin e Kirgistanit.

Safed-Bulan është qendra e parë e përhapjes së Islamit në Kirgistan.

Deri në shekullin e VII të erës sonë, besime të ndryshme fetare pagane si zoroastrianizmi dhe budizmi, nestorianizmi (drejtimi lindor i krishterimit), manicheanizmi, teizmi, etj, mbizotëronin në territorin e Kirgistanit, ashtu si në rajone të tjera të Azisë Qendrore. Megjithatë, asnjë nga ato besime fetare nuk u bë besimi dominues që të përfshinte pjesën më të madhe të popullsisë vendase, deri në

ardhjen e Islamit. Nuk është e tepruar të thuhet se midis këtyre besimeve tyre, Zoti i Plotfuqishëm, i Cili u pranua mes banorëve të Azisë Qendrore në periudhën para erës sonë - besimi i cili është përcjellë deri në epokën e re - ka pasur një ndikim të madh tek turqit nomadë dhe tek kirgizët.

Megjithëse hyrja aktive e ndikimit të Islamit në territorin e Kirgistanit filloi në mesin e shekullit të 8-të të erës sonë, nga historia dihet se kontakti i parë i të parëve tanë me këtë fe të madhe botërore ka ndodhur njëqind vjet më përpara (në mesin e shekullit të VII). Kjo ngjarje lidhet me historinë e lashtë të fshatit “Soot-Bulan (Safed-Bulan)”, që ndodhet në kufirin e rrethëve Aksy dhe Ala-Buka të rajonit të sotëm Xhelal-Abad, të Kirgistanit.

Bazuar në burimet lokale mitologjike, në ato arabe dhe në kërkimet e mëvonshme, ardhja e parë e arabëve muslimanë në rajonin Aksi, ishte gjatë periudhës së kalifit të tretë, Osmanit (644-656), dhe kalifit të katërt, Aliut (656-661). Për këtë flasin edhe burimet arabe, si në librin “Mulhakat El-Surukh”, të autorit Xhemal Karshi, një shkencëtar dhe poet, i cili lindi në vitin 1230 në qytetin Almalyk, në brigjet e lumit Ile.

“Në në kohën e kalif Osmanit, ushtarët myslimanë u dërguan në Ispid-Bulan (Safed-Bulan), nën komandën e Muhamed ibn Xheririt, dhe 2700 ushtarë shokë të Profetit (alejhi selam) dhe ndjekës të tyre (sahabe dhe tabi'inë) ranë dëshmor në luftën me të pafetë” - citon V. V. Bartol. në veprën e tij.

Me këtë rast nuk u arrit fitore për Islamin në atë rajon.

Por, procesi i përhapjes së vërtetë të Islamit në rajonin e Kirgistanit filloi me ekspeditën e madhe të sundimtarit të Khorasanit, Kutejbe ibn Muslim, Zoti e mëshiroftë, në vitet 709 - 711. Në 3-4 vjet ai mbuloi Sogdian, Khorezmian dhe pjesën më të madhe të Tokharistanit.

Roli i Muslim ibn Kutejbes në prezantimin Islamit në Azinë Qendrore vlerësohet shumë në historiografinë arabe. Falë tij, njerëzit e Buharasë hynë në Islam...”.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

www.britannica.com
www.worldometers.info
www.marefa.org
www.en.wikipedia.org
www.kghistory.akipress.org

PARKU 'TRIUMFI', BASHKEK



MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI PARA NJË GRUPI TË RINJSH TË KISHËS KATOLIKE



Ditën e martë, më 26 korrik 2022, në xhaminë e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti famullitarin e Famullisë Blinisht-Gjadër, Dom Alberto Galimberty, së bashku me një grup studentësh dhe të rinjsh, misionarë dhe vullnetarë të kësaj famullie.

Myftiu i uroi mirëseardhjen vizitorëve të kësaj famullie, i njohu me historikun e xhamisë së Parrucës, jetën fetare islame në qytetin e Shkodrës, por edhe për vlerat dhe rëndësinë që ka ruajta e harmonisë, tolerancës dhe respektit ndërfetar, si një kontribut i domosdoshëm për ngritjen e harmonisë

kombëtare dhe shpirtërore në realitetet tona shqiptare dhe përtej tyre.

Myftiu iu përgjigj edhe shumë prej pyetjeve të të rinjve të pranishëm në xhami, duke e kthyer këtë vizitë në një bashkëbisedim të këndshëm në mesin e të rinjve katolikë dhe Myftiut.

Të rinjtë u interesuan të dinin edhe rreth besimit islam, shtyllave dhe kushteve të tij, rreth mënyrës së riteve fetare, si dhe detaje të tjera që lidhen me jetën e xhamisë.

Vizita e miqve nga Famullia e Blinisht-Gjadër u mbyll me një foto të përbashkët si kujtim i bukur i një takimi të përzemërt e me shumë vlerë.



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“

Mësoni

prej diturive

sa të dëshironi,

se pasha Allahun

nuk do të

shpërbleheni

për mbledhjen

e diturive,

derisa të punoni

me to!



(Transmeton Ebul-Hasen El-Medini, nga Enesi)

40 HAXHILERË NGA SHKODRA U PËRCOLLËN SOT PËR TË KRYER HAXHIN E SIVJETSHËM...

Ditën e hënë, më 4 korrik 2022, pasi u fal me xhematë namazi i iqindisë në xhaminë e Parrucës, u bë përcjellja e 40 haxhilerëve nga Shkodra, të cilët u nisën për në Mekë për të kryer detyrën e Haxhit.

40 haxhilerë nga Shkodra u përcollën për të kryer Haxhin e sivjetshëm dhe do të qëndrojnë në vendet e shenjta, deri më 22 korrik 2022.

Në prani të mediave, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B.



Sytari, uroi haxhilerët e sivjetshëm, të cilët udhëtojnë për të kryer ritualet e Haxhit, duke treguar, se ky udhëtim i këtyre besimtarëve, është një bekim i madh për Shkodrën dhe mbarë Shqipërinë.

Në përcjellje të haxhilerëve ishin të pranishëm, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, imamë të xhamive të qytetit e fshatit, familjarë të tyre dhe shumë besimtarë të shumtë.

PROGRAM ME LIGJËRATA DHE KËSHILLA FETARE NË XHAMITË E QYTETIT

Myftinia Shkodër gjatë muajve qershor dhe korrik 2022, ka zhvilluar në ambiente të hapura, çdo të mërkurë një program të larmishëm me ligjëratat dhe këshilla fetare në disa xhami të qytetit me qëllim

këshilla të dobishme për besimtarët e pranishëm, por edhe për ndjekësit përmes rrjeteve sociale të Myftinisë Shkodër, të cilat janë transmetuar live në facebook nga profili i Myftinisë Shkodër.

Altin Nikshiqi dhe H. Ruzhdi Plangaj, në xhaminë e "Dy Vajzave", me tematikë: "Rinia", me ligjërues: H. Lavdrim Hamja dhe H. Besim Barbullushi, në xhaminë Tophanë, me tematikë: "Mosha e tretë", me ligjërues: Myftiu i Shkodrës, Imam



të njohjes më afër dhe më të zgjeruar me frytet e besimit të pashtershëm, të forcimit të lidhjes me Krijuesin e gjithësisë dhe konsolidimin dhe ruajtjen e vlerave morale-edukative.

Imamët e nderuar përmes temave të ndryshme kanë përçarur mesazhe dhe

Konkretisht, programi i ligjëratave është zhvilluar në xhamitë: "Ebu Bekër", me tematikë: "Ihsani", me ligjërues: H. Idmir Plaku dhe H. Gilman Kazazi, në xhaminë e Parrucës, me tematikë: "Bujaria", me ligjërues: H. Naim Drijaj dhe H. Durim Kasemi, në xhaminë Kiras, me tematikë: "Familja", me ligjërues: H.

Muhamed B. Sytari dhe teologu Arben Halluni dhe në xhaminë e Medresesë, me tematikë: "Dituria", me ligjërues H. Adil Cukali dhe H. Ervil Kuçi.

Ndërsa, vazhdimi i këtij programi dhe përmbyllja e saj do të jetë në tre xhami të tjera të qytetit gjatë muajit shtator 2022.

Në ditën e parë të Kurban Bajramit dhe ditën e dytë të kësaj feste madhështore, përfaqësues të Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni dhe teologu Lavdrim Hamja zhvilluan vizita uruese në disa institucione të qytetit dhe gjithashtu dhuruan edhe kurbane për këto institucione.

Gjatë vizitave uruese për Bajram të përfaqësuesve të Myftinisë Shkodër në institucionet e kujdesit socialë, "Shtëpia e të Moshuarve" dhe Shoqata e Para-Tetraplegjikëve, Shkodër u dhanë mesazhe për humanizëm, përkrahje të vazhdueshme dhe kujdes të veçantë për këtë shtresë sociale!

Këto vizita u pasqyruan edhe në mediat vendore.

VIZITA URIMI ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT



MYFTINIA VIZITON TË MOSHUARIT PËR KURBAN BAJRAM



KURBAN BAJRAMI PËR PARA-TETRAPLEGJIKËT
MYFTINIA SHKODËR SHPERNDAU 60 PAKO ME MISH BEQIRI: DUHET EDHE PERKUIJESIA E INSTITUCIONEVE

KURBAN BAJRAMI, FESTA E SAKRIFICËS DHE E SOLIDARITETIT

Me rastin e festës së begatë të Kurban Bajramit 1443/2022, Myftinia Shkodër ka realizuar me sukses procesin e kurbaneve.

Gjatë ditëve të festës së madhe të Kurban Bajramit janë therë dhe shpërndarë me dhjetëra kurbanë, prej bagëtive të imëta dhe të trasha, e me qindra paketa mishi, si dhuratë e kësaj feste të sakrificës, por edhe si ndihmë dhe përkrahje për njerëzit dhe familjet në nevojë.

Myftinia Shkodër falënderon shoqatat partnere, Helping Hand USA, Mirësia, etj, si dhe të gjithë ata, të cilët na besuan këtë rit të kësaj feste të begatë, nga Zvicra, Kanadaja, Gjermania, Italia, Anglia, etj.



Të enjten, më 21 korrik 2022, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit organizoi në zonën turistike të Razmës, aktivitetin/ekskursionin veror të radhës më nxënësit e kurseve fetare të xhamive Kiras, Bahçallëk, Barbullush dhe Ganjollë.

Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 110 nxënës e nxënëse të katër xhamive, të cilëve u jepet mundësia, që përveç dijes dhe edukatës të vlefshme për formimin e duhur të karakterit të tyre, të përfshijnë edhe veprimtari argëtuese dhe zbavitëse.

Drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, pasi i uroi pjesëmarrjen e tyre në këtë organizim të Myftinisë u mbajti një bisedë fetare, ku u foli për vlerën që ka zhvillimi i mësim-besimit, të cilat i mbajnë fëmijët larg veseve, i argëtojnë dhe u japin edukimin e nevojshëm islam dhe qytetar. Ai tha se ndërthurja e mësimdhënies me argëtimin i jep gjallëri ditës së tyre si dhe pranisë së vazhdueshme në kurset/mejtepet fetare.

Sipas programit të aktivitetit u zhvilluan biseda brenda grupeve të kurseve, u organizuan lojëra zbavitëse dhe sportive, shëtitje në natyrë, etj.

AKTIVITET VEROR MË NXËNËSIT E XHAMIVE



NË XHAMINË “EBU BEKËR”

U ZHVILLUA CEREMONIA E MBYLLJES SË KURSIT VEROR “BUZ’QESH”

Ditën e xhuma, më 22 korrik 2022 në ambientet e xhamisë “Ebu Bekër”, përmes një ceremonie u bë mbyllja e kursit veror intensiv, “Buz’qesh”, i organizuar nga Myftinia Shkodër.

Fillimisht, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni falënderoi bashkëpunimin e vyer të teologes Zamira Bushati për koordinimin e kësaj platforme të re në edukimin e fëmijëve me dashurinë ndaj Krijuesit të gjithësisë, mësueset psikologe, znj. Admira Guri dhe znj. Almeda Tusha, për përkushtimin dhe punën e tyre të palodhur gjatë gjithë procesit mësimor të kursit, si dhe prindërit të cilët dërguan fëmijët e tyre në këto programe me karakter edukativ dhe zbavitës.

Gjatë kësaj ceremonie fëmijëve iu shpërndanë dhuratat dhe për më të mirët në pjesëmarrje certifikata vlerësimi.

Në fund, mësueset së bashku me fëmijët i dhuruan teologut Arben Halluni një dhuratë simbolike në shenjë mirënjohjeje për mbështetjen dhe angazhimin e tij në mbarëvajtjen e këtij kursi veror.



Kujtojmë, se gjatë kursit veror, që zgjati plot 5 javë dhe që u mbajt në qendrën kulturore të Myftinisë Shkodër në Zdrallë, si dhe në mjediset e jashtme dhe të brendshme të xhamisë

“Ebu Bekër”, janë zhvilluar veprimtari kulturore, pikniqe, lojëra kreative përmes artit, etj.

“Buz’qesh” ishte një strukturë dhe mision në vetvete, i ndërtuar duke marrë në konsideratë nevojat e fëmijëve në një fazë të rëndësishme të zhvillimit. Përkrah lojës, është ndërthurur në natyrshmërinë e këtyre shpirtërave të bukur, edhe kuptimi i emrave të Zotit.

Përmes njohjes së këtyre të fundit, bota e brendshme e tyre plotësohet dhe orientohet në harmoni drejt qëllimit të krijimit. Me ndihmën e Zotit kjo dije do të ketë vazhdimësi.

VEPRIMTARI VERORE ARGËTUESE ME NXËNËSIT E KURSEVE FETARE NË RRJOLL



Ditën e mërkurë, më 27 korrik 2022, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit organizoi në Rrjoll të Velipojës, veprimtarinë e radhës më pjesëmarrjen e 30 nxënësve të kurseve fetare, konkretisht të xhamive Ura e Bunës, Alimetaj dhe Velinaj, nën kujdesin e imamë-mësuesve të mësim-besimit: Ridvan Luzaku, Lulzim Beqiri dhe Nebi Alia.

Në këtë veprimtari mori pjesë edhe

drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili fillimisht i uroi pjesëmarrjen e fëmijëve në këtë ekskursion si dhe u dha disa këshilla dhe udhëzime për mbarëvajtjen sa më mirë dhe të këndshme të këtij aktiviteti edukativ dhe argëtues.

Më pas, sipas programit u zhvilluan lojëra sportive si: minifutboll, volejboll, lojëra zbavitëse, larje në det, biseda brenda secilit grup, etj.




Sheikh Muhamed El-Gazali

“

*Xhamia, në epokën
e parë, ka genë vatra
e tërë familjes;
burrat në safat
(rreshtat) e parë,
fëmijët më safat
(rreshtat) e mesëm
dhe gratë në safat
(rreshtat) e fundit.
Fëmijët sikur
ndodheshin mes dy
kllapave, mes burrave
dhe grave,
mes baballarëve
dhe nënave!*



**MYFTINIA SHKODËR JU URON TË GJITHËVE:
ME ZEMËR TË MIRË DHE PLOT BEGATI KURBAN BAJRAMIN!**



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org